



DAV

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE  
SHERBIMEVE MBESHTETESE

Nr. 20149 prot

Vlorë, 13.12.2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ .2024

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË V.K.B-NË NR. 96, DATË 07.12.2023”  
“PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË TERRITORIN E BASHKISË  
VLORË, PER VITIN 2024” SI DHE PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE  
VENDORE PËR VITIN 2025”**

Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_ .2024, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë Vlorë, mbështetur në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, neni 9 pika 1.1 gërmat a, b, pika 1.3, Neni 35 dhe Neni 54 pika f;
- Ligjin 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”;
- Ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar,
- Ligjin nr.98/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”
- Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"
- VKM nr. 408, datë 31.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"
- Ligjin 24/2017 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujëtjes dhe kullimit” neni 17,18,19;
- Ligjin 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar
- VKM nr.132, datë 07.03.2018, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar.
- VKM nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”,
- V.K.B-së nr.96, datë 07.12.2023 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë, për vitin 2024”

**VENDOSI:**

Në kreun II- TARIFAT VENDORE, të bëhen shtesat si më poshtë:

1. Tarifat për zërin e hapësirave publike, të shtohet pika 8, sipas tabelës:

Nr.	Emërtimi	Vlera lekë/m <sup>2</sup> /vit
8	Për zënie të hapësirës publike për subjektet që ushtrojnë veprimtari tregëtare:  - ATM pajisje elektronike  - Karikues për mjetet elektrike	1.000

2. Tarifa e shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve, ndriçimit, gjelbërimit

- Pika E të zëvendësohet me E.1.a
- Të shtohet paragrafi E.1.b
- Të shtohet paragrafi E.1.c

Nr.	Bizneset sipas grupeve			
		Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve	Tarifa e ndriçimit	Tarifa e gjelbërimit
E.1.a	<i>Subjektet që kanë selin kryesore jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe që ushtrojnë aktivitet me adrese dytesore në këtë territor.</i>	123,000	18,000	9,000
E.1.b	<i>Subjektet që kanë selin kryesore jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe që ushtrojnë aktivitet me adrese dytesore në këtë territor, vlerësimi tatimor të kryhet në bazë të xhiros vjetore të deklaruar nga tatimpaguesi, vërtetuar me dokumentacionin e konfirmuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve.  Në rast të mungesës së vërtetimit të xhiros, vlerësimi tatimor do të aplikohet sipas pikës E.1.a</i>			
E.1.c	<i>Subjektet që kanë selinë kryesore në territorin e bashkisë Vlorë dhe ushtrojnë aktivitet edhe në adresa të tjera Brenda territorit të bashkisë, vlerësimi tatimor të kryhet në bazë të xhiros vjetore të deklaruar nga tatimpaguesi, vërtetuar me dokumentacionin e konfirmuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë.  Në rast të mungesës së vërtetimit të xhiros, vlerësimi tatimor do të aplikohet sipas pikës A dhe C të tabelës.</i>			

Përfshihen për vlerësimin tatimor nga niveli i tarifës së pikës E.1.b, subjektet të cilët ushtrojnë veprimtari tregëtare në:

- Fushën e ndërtimit
- Institucionet financiare si: bankat e nivelit të dytë, subjektet financiare jo banka (sipas kuadrit ligjor janë institucione të tilla si: kredihënia, mikrokredia, faktoringu, qiraja financiare, shërbimi i pagesave dhe transferimit të parave, emetimi i parasë elektronike, këmbim valutë etj...) dhe Agjencitë e Sigurimit.

Për këto subjekte vlerësimi tatimor do të kryhet sipas pikës E.1.a.

3. Afati i pagesës së detyrimeve për institucionet shtetërore, vlerësimi tatimor i të cilave bëhet sipas pikës G të tabelës së pikës 2, kreu II të jetë data 20 tetor 2025.

4. Në kreu II- TARIFAT VENDORE, të bëhen shtesat si më poshtë:  
Të ndryshohet paragrafi pika 1 , a/2 si më poshtë

Ishte: Struktura përgjegjëse për përlogaritjen e detyrimit për stacion plazhi është Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.

Ndryshohet :Struktura përgjegjëse do të jetë Drejtoria e të Ardhurave Vendore e cila do të ndjekë procedurën e vlerësimit tatimor dhe arkëtimin e këtij detyrimi sipas informacionit të dërguar (Planvendosjes) nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.

-Në pikën 7, pika 12 dhe 13 shtohet si më poshtë:  
Përfitojnë ulje me 50% të vlerës për shërbimet e mësipërme kategoritë student ( Student të pajisur me kartën e studentit.)

-Në pikën 8/a do të shtohet nënpika 11, si më poshtë :  
Përfitojnë ulje me 50% të vlerës për shërbimet e mësipërme kategoritë student ( Student të pajisur me kartën e studentit)

-Në pikën 8/d do të shtohet nënpika 3 si më poshtë:  
Përfitojnë shërbimin falas kategoritë student ( Student të pajisur me kartën e studentit)

5. Miratohen Taksat dhe Tarifat Vendore për vitin 2025, të miratuara sipas VKB-së nr. 96, datë 07.12.2023, me ndryshimet e mësipërme.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015“Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55, pika 6 dhe efektet financiare fillojnë në datën 01 Janar 2025.

KRYETAR

Ermal Dredha

